UDHËZIM
Nr. 13, datë 2.6.2022

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 3606/2, DATË 28.10.2011, "PËR PAJISJEN E DREJTUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E DHE DE, ME CERTIFIKATËN E AFTËSISË PROFESIONALE (CAP)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës, pikave 8 dhe 9, të nenit 115, të nenit 224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 294, 295, 296 dhe 297, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011, "Për pajisjen e drejtuesve të mjeteve rrugore të kategorive C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)", të ndryshuar, bëhet shtesa:

1. Pas nenit 32 shtohet neni 32/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Neni 32/1
Dispozita kalimtare

1. Zotëruesit e një certifikatë të aftësisë profesionale të vlefshme, CAP, do të kryejnë rinovimin e CAP, pa kryer trajnim periodik dhe test teorik.

2. Trajnimi periodik dhe testi teorik, sipas nenit 28 të këtij udhëzimi, fillon pas datës 20.10.2025.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku